



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 27 nëntor 2013**

**Numri i lëndës: 2013-19**

**U.**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 27 nëntor 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar në Panel më 10 korrik 2013. Më 11 nëntor 2013 parashtruesi i ankesës ka parashtruar informata shtesë lidhur me lëndën. Parashtruesi i ankesës ka kundërshtuar që emri i tij/saj të bëhet publik dhe si rrjedhojë do të përmendet si "U.".

## II. FAKTET

2. Faktet e mëposhtme janë pranuar në bazë të informatave që janë parashtruar nga ankuesi/ankuesja:

### Ankesat para gjykatave të Kosovës

3. U. pohon se më 28 mars 2011, ai/ajo kishte parashtruar një ankesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me nxjerrjen e Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor në Kosovë, për të cilën ai/ajo kurrë nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje. Sipas ankuesit/ankueses, ai/ajo nuk mund t'i gëzojë drejtat e tij/saj në pension, pasi nuk është shpallur ligji i duhur.
4. Në mes të prillit 2011 dhe majit 2013, U. kishte parashtruar një numër ankesash dhe amendamente të tyre në gjykata dhe institucione të ndryshme të Kosovës.
5. Më 20 shtator 2012, U. gjithashtu kishte parashtruar një ankesë në "Komisionin Evropian për Legjislacion në Bruksel përmes Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Prishtinë, Kosovë, kundër Qeverisë së Kosovës për mos nxjerrjen e Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor dhe Ligjit për sigurimin shëndetësor në Kosovë". Më 13 tetor 2012, U. kishte kërkuar nga Komisioni Evropian për të zgjidhur çështjen jo më vonë se deri me datën 30 tetor 2012. Më 5 mars 2013, U. kishte marrë një përgjigje nga Gjykata Evropiane se ai/ajo duhet të parashtojë padi kundër Këshillit Evropian e jo kundër Komisionit Evropian.

### Ankesat tek EULEX-i në Kosovë

6. Më 28 mars 2013, U. kishte parashtruar një ankesë pranë EULEX-it në Kosovë kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës "*në mënyrë që t'i detyroj ata të nxjerrin Ligjin mbi sigurimin pensional dhe invalidor*". Më 10 prill, 29 prill, 8 maj, 23 maj, 29 maj ankuesi/ankuesja kishte paraqitur parashtrime dhe kërkesa të tjera për të ndryshuar padinë e tij/saj pranë EULEX-it.
7. Më 8 maj 2013, U. kishte parashtruar një ankesë në Zyrën e Këshillit Evropian në Kosovë kundër EULEX-it "*për heshtje administrative dhe për refuzimin e ankesës sime, duke menduar se ankesa kundër EULEX-it mund të parashtrohet në atë zyrë*". Kjo ishte shtojca përmes parashtrësave të tjera me datën 15 maj 2013.
8. Më 14 qershor 2013, U. ishte njoftuar nga një burim i papërcaktuar "*se ankesa kundër EULEX-it duhet të parashtrohet në Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut*".

9. Më 19 qershor 2013, U. kishte tërhequr kërkesën nga Këshilli Evropian lidhur me nxjerrjen e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.

### **Komente të tjera nga ankuesi/ankuesja**

10. Ankuesi/ankuesja pohon se Qeveria e Kosovës kishte dhënë premtim publik nëpërmjet shtypit se Ligji pensional do të zbatohet pas vitit 2008 dhe kishte thënë se shumica e pensioneve do të shkonte 60€ - 180€. Ankuesi/ankuesja po ashtu ka paraqitur parashtrime të tjera në lidhje me mangësitë e dyshuara të kornizës ligjore sa i përket padisë së tij/saj.

### **III. ANKESAT**

11. Ankuesi/ankuesja mbështetet në një numër të drejtave të mbrojtura përfshirë nenet 1, 2, 7, 8 dhe 29, paragrafi 2 i Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut; nenin 2, paragrafin 1 dhe 3, (a), nenin 5, nenin 14, paragrafin 1, nenin 17, paragrafin 2, nenin 25, paragrafin 1 dhe nenin 26 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; si dhe nenin 1 dhe 14 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj) dhe Nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNj. Më tej, ankuesi i referohet Kartës Sociale Evropiane.

### **IV. LIGJI**

12. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
13. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganës.
14. Paneli konsideron se ankesa e ankuesit/ankueses, në thelb ka të bëjë me faktin se autoritetet e Kosovës nuk e kanë nxjerrë Ligjin mbi sigurimin pensional dhe invalidor. Paneli konstaton se nuk është argumentuar e leje më të jetë treguar se EULEX-i ka qenë në ndonjë formë i përfshirë në shkeljen e dyshuar të të drejtave të ankuesit/ankueses. Më tej, çështja për të cilën ka pasur ankesë, pra mos nxjerrja e një ligji, për arsye të qarta nuk hyn në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX në Kosovë, ku përfshinë disa fusha të caktuara në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganës.

15. Del se këto çështje të ngritura nga ankuesi/ankuesja nuk hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë. Rrjedhimisht ato janë jashtë kompetencës së Panelit, siç është formular në rregullën 25 të rregullores së punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.

**PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, gjen se kjo ankesë bie jashtë kompetencës së Panelit sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

**SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese